

**STATUTI**  
**I**  
**“ GREEN VIEW ALTERNATIVE INVESTMENT FUND”**  
**SHOQËRI KOMANDITE SIK**

**Neni 1 – Data e themelimit dhe emri i Shoqërisë**

- 1.1 Kjo shoqëri komandite është themeluar në datë 21.10.2021.
- 1.2 Emërtimi i shoqërisë është “Green View Alternative Investment Fund”– Shoqëri Komandite SIK më poshtë e quajtur “Shoqëria”.
- 1.3 “Green View Alternative Investment Fund”, Shoqëri Komandite SIK, është një shoqëri komandite, e themeluar rregullisht në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 1.4 Shoqëria Komandite SIK është fond investimesh alternative<sup>1</sup> ofruar vetëm klientëve profesionistë<sup>2</sup> dhe të kualifikuar<sup>3</sup>.
- 1.5 Shoqëria Komandite SIK, me seli të regjistruar dhe zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë, e cila është shoqëri Komandite SIK, vetëm për klientë profesionistë dhe të kualifikuar regjistrohet si fond investimesh alternative nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

**Neni 2 – Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr.Nikolla Tupe, Nr.1, Kati 3, Tiranë, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë.
- 2.3 Mbledhja e Ortakëve të Shoqërisë, mund të vendosë krijimin ose mbylljen e selive dytësore, zyra, degë të shoqërisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç selisë qendrore të Shoqërisë, në Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 – Objekti**

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- 3.1.1. Investimi i diversifikuar i pasurisë në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme të çdo lloji.
- 3.1.2. Ofrimi i fitimeve për Ortakët nga investimi në një portofol të diversifikuar aktivesh.

**Neni 4- Kohëzgjatja**

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të papërcaktuar.



<sup>1</sup> “Fond i investimeve alternative (FIA)” - Ligji 56/2020 “Për Sipëmarrjet e Investimive Kolektive”, neni 2, pika 24

<sup>2</sup> “Klient profesionist” – Ligji 56/2020 “Për Sipëmarrjet e Investimive Kolektive”, neni 2, pika 35.1

<sup>3</sup> “Klient i kualifikuar” – Ligji 56/2020 “Për Sipëmarrjet e Investimive Kolektive”, neni 2, pika 35.3

## Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë

- 5.1 Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë përbëhet prej 1,674,378,000 lekë, i ndarë në numër kuotash prej 1,674,378 me vlere nominale prej 1,000 Lek secila.
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga kontribute në natyrë dhe në para (likuide) dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë si më poshtë vijon:
- Pjesëmarrja e ortakut themelues me përgjegjësi të pakufizuar, Banka CREDINS sh.a., përbëhet nga kontribute në natyrë dhe nga kontribute në para, në nivelin 97.91%, të kapitalit themeltar, me barasvlerën prej 1,639,378,000.00 lekë të përbërë prej 1,629,378,000 lekë kontribute në natyrë dhe 10,000,000 lekë kontribute në para, me numër 1,639,378 kuotash. Kontributi në natyrë përbëhet nga pasuritë e paluajtshme, që përshkruhen në Aneksin bashkëngjitur, si dhe në raport vlerësimin e dakordësuar midis ortakëve për efekte të shprehjes së tyre në para.
  - Pjesëmarrja e ortakut themelues me përgjegjësi të kufizuar, Z. Arjan Hana, përbëhet nga kontribute në para dhe është në nivelin 2.09%, të kapitalit themeltar, me barasvlerën prej 35,000,000 lekë (njetzet e pesë milion), si dhe me numër 35,000 kuotash.

## Neni 6 – Kapitali, Zmadhimi dhe Zvogëlimi

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja të pjesëve të kapitalit themeltar me derdhje në para ose me kontribute në natyrë për ortakët ekzistues.
- 6.2 Kapitali themeltar mund të zmadhohet, nëpërmjet kontributeve të reja edhe për Ortakë të rinj. Ortakët e rinj të cilët bëhen pjesë e shoqërisë pas periudhës së themelimit dhe regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), do të jenë efektive pas pranimin të Statutit, Prospektit, Marrëveshjes së bashkëpunimit me shoqërinë administruese dhe rregulloreve të shoqërisë.
- 6.3 Kapitali i shoqërisë mund të rritet sa herë që ortakët e pakufizuar e shikojnë të arsyeshme duke ja bërë të ditur me anë të një njoftimi për rritjen e kapiatit (i cili do të kryhet nga Administratori i shoqërisë) Ortakëve të tjerë të kufizuar. Cdo Ortak i shoqërisë do të ketë të drejtën të derdhë kontribute të reja në kapitalin e shoqërisë në masën e përcaktuar me Ortakët e pakufizuar të shoqërisë dhe të përcaktuar në Vendim.
- 6.4 Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë, nga ana e një Ortaku, duhet të ketë marrë paraprakisht pëlqimin nga ana e Ortakëve të pakufizuar të shoqërisë.
- 6.5 Në asnjë rast Ortakët e shoqërisë nuk mund të detyrojnë Ortakët e tjerë për të rritur angazhimin e tyre, në kapitalin themeltar të shoqërisë, apo dhe shtesat e tjera që mund të kryhen në vazhdim.
- 6.6 Zvogëlimi i kapitalit ndodh në rastet kur secili ortak i shoqërisë merr vendim për tërheqjen nga kapitali të pjesës së tij takuese, duke njoftuar paraprakisht të gjithë Ortakët.
- 6.7 Vendimi për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar i njoftohet QKB-së dhe publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë.



## Neni 7 – Transferimi i Kuotave dhe e Drejta e parablerjes

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë janë lirisht të transferueshme midis Ortakëve të Shoqërisë, pjesërisht ose plotësisht. Transferimi mund të realizohet nëpërmjet shitjes, trashëgimisë, dhurimit ose në çdo formë tjetër të parashikuar në ligj. Transferimi i kuotave nuk mund të realizohet pranë të tretëve, nëse më parë nuk është ushtruar e drejta e parablerjes në favor të Ortakëve të tjerë ekzistues.
- 7.2 Megjithatë, në këtë rast, transferimi duhet t'u komunikohet me shkrim Ortakëve të tjerë të Shoqërisë.
- 7.3 Çdo Ortak që ka për qëllim transferimin e pjesës së tij të kapitalit në Shoqëri, në tërësi apo pjesërisht, personave të tretë do të njoftojë me shkrim si Ortakët e tjerë ashtu dhe Shoqërinë Administruese.
- 7.4 Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave, me kushte të barabarta.
- 7.5 Çdo transferim i kuotave/aksioneve në kundërshtim me këtë nen do të jetë nul dhe i pavlefshëm.

## Neni 8 – Organet drejtuese të Shoqërisë

8.1 Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Administratori/ët

## Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme, të Drejtat dhe Detyrimet

- 9.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statut apo në bazë të ligjeve në fuqi, Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
- a) ndryshime të statutit;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve, ndarjen e kompetencave ndërmjet tyre;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
  - h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
  - j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Administratorit dhe/apo raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- 9.3 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund të kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



## Neni 10- Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme


- 10.1 Asambleja e Përgjithshme do të thirret në rastet e parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statuti dhe sa herë që është e nevojshme me qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori i shoqërisë.

## Neni 11 - Mënyra e Thirrjes, Rendi i Ditës

- 11.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do t’u njoftohet Ortakëve me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë Ortakëve të paktën 21 ditë kalendrike përpara datës së parashikuar të mbledhjes.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbajtur rregullisht edhe në rast se nuk janë respektuar formalitetet e thirrjes, në rast se janë të pranishëm të gjithë Ortakët dhe shprehen dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.
- 11.3 Në rastet kur Ortakët me përgjegjësi të pakufizuar e shohin të arsyeshme, Asambleja e Përgjithshme mblidhet në një periudhë më të shpejtë kohore, duke i’u bërë të ditur të gjithë Ortakëve të tjerë të shoqërisë dhe Administratorit të shoqërisë së bashku me argumentet përkatëse.

## Neni 12 - Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja në Asamble

- 12.1 Cdo Ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë të Përgjithshme, vetë ose nga një përfaqësues i emëruar prej tij, në bazë të një autorizimi.
- 12.2 Cdo Ortak i shoqërisë ka të drejtë të zgjedhë si përfaqësuesin e tij në punimet e Asamblesë së Përgjithshme, një ortak tjetër të shoqërisë.
- 12.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 12.4 Mbledhjet e Asamblese mund të zhvillohen me mjetet elektronike të komunikimit, telekonferencë, videokonferencë apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë identifikuar dhe t’u jetë dhënë mundësia për të ndjekur diskutimin dhe komunikimin e ndërsjellë në kohë reale nga një vendndodhje tjetër, duke përdorur mjete teknike të nevojshme për përdorimin proporcional për arritjen e këtyre qëllimeve.
- 12.5 Në rastet e tjera, ortakët që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e thirrur për t’u zhvilluar, mund të jenë pjesëmarrës në mbledhje, duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit, telekonferencë, videokonferencë apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë identifikuar dhe t’u jetë dhënë mundësia për të ndjekur diskutimin dhe komunikimin e ndërsjellë në kohë reale nga një vendndodhje tjetër, duke përdorur mjete teknike të nevojshme për përdorimin proporcional për arritjen e këtyre qëllimeve.
- 12.6 Nëse plotësohen dhe zbatohen kriteret e mesiperme, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllim mbajtjen e minutave të takimit, nënshkrimin e procesverbaleve përkatëse. Procesverbali i mbledhjes së Asamblese do të përmbajë përshkrimin e rendit të ditës dhe vendim-marrjen e Asamblese. Numerimi i votave do të bëhet



nga ana e sekretarise se Asamblese dhe do te nenshkruhet nga Kryetari i Asamblese. Ky procesverbal, ku permbahet si me siper, si dhe nenshkrimi i Kryetarit dhe Sekretarit te Asamblese perfaqeson vendimin e rregullt te Asamblese dhe mund te paraqitet per regjistrim prane Intitucioneve perkatese, ne rastet e caktuara nga ligji.

- 12.7 Kuorumi i nevojshem per zhvillimin e bledhjes lidhur me vendimarrjet e saj ne baze te rendit te percaktuar, eshe prezenca e mbi 50 % e Ortakëve te pjeses takuese ne kapitalin e shoqërisë.
- 12.8 Cdo ortak i shoqërisë, po ashtu edhe perfaqësuesit perkates te tyre, kanë te drejten e votës ne raport me perqindjen (%) e kapitalit qe ato zotërojne ne shoqëri. Asnje prej Ortakëve apo perfaqësuesve te tyre nuk ka te drejte te ndaje perqindjen e votës qe zotëron ne krahët e kundërta te votimit.
- 12.9 Ne rastet kur 100 % e Ortakëve me pergjegjesi pakufizuar te Asamblesë se Pergjithshme vendosin kundër pjeses tjetër te Ortakëve te shoqërisë, atëherë vota e Ortakëve me pergjegjesi te pakufizuar mbizotëron.
- 12.10 Përvec nese parashikohet ndryshe ne këtë statut apo marrëveshje mes Ortakëve (nese ka) Asambleja e Pergjithshme merr vendime me shumicë te thjeshtë.

### Neni 13 - Administrimi

- 13.1 Ortaku me pergjegjesi te pakufizuar dhe/apo Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te tretëve, për shkelje te ligjeve apo shkelje te Statutit.
- 13.2 Përvec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikërisë, sipas neneve dhe dispozitave te ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:
  - a) Te kryejë detyrat e tij te percaktuara ne ligj, Statut dhe marrëveshje ndërmjet Ortakëve (nese ka), ne mirëbesim e ne interesin më te mirë te shoqërisë ne tërësi, duke i kushtuar vëmendje te vecantë ndikimit te veprimtarisë se shoqërisë ne mjedis;
  - b) Te ushtrojë, vlerësojë me pergjegjesi çështjet për te cilat merren vendim;
  - c) Te parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit te interesit, present apo te mundshëm, te interesave personale me ato te shoqërisë;
  - d) Te ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm.
- 13.3 Ortaku me pergjegjesi te pakufizuar dhe/apo Administratori, gjatë kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne mënyrë te arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim te rasteve kur veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirëbesim.
- 13.4 Shoqëria Komandite, qe eshte fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe te kualifikuar, ka te drejte te emërojë nërmjet një marrëveshje me shkrim, një shoqëri administruese, ne zbatim te ligjit 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive për administrimin dhe investimin e kapitalit te saj, përfshirë edhe percaktimin e politikës se investimit, si dhe marketimin e fondit.
- 13.5 Shoqëria Administruese sipas pikës 13.4 te këtij neni, do te jetë: "Credins Invest sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve.
- 13.6 Ortaku me pergjegjesi te pakufizuar, ne zbatim te ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (shih dhe nenet 56/2, 59 dhe 34 te po këtij ligji), duke u dakordësuar dhe me ortakun tjetër, kanë vendosur qe administrimi i veprimtarisë se përditshme te realizohet edhe nga Znj. Ina Karapanco, e dtl. 15.10.1988, person madhor dhe me zotësi te plotë juridike për te vepruar, identifikuar me ID Nr.034870237 dhe me numër personal I86015044C.



## **Neni 14 – Viti ushtrimor**

- 14.1 Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.
- 14.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet në 31 Dhjetor.

## **Neni 15 – Përdorim i Levës Financiare**

Shoqëria Komandite SIK mund të përdorë levën financiare në rast se do ta gjykojë të nevojshme dhe të përrshtatshme. Niveli maksimal i levës financiare do të jetë 50% të aseteve, ose raporti Borxh/Kapital jo më i madh se 1.

## **Neni 16 – Audituesit e Jashtëm**

- 16.1 Kontrolli i jashtëm financiar i shoqërisë bëhet nga një ose më shumë auditues të jashtëm të autorizuar, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit.
- 16.2 Audituesi/it e jashtëm të Autorizuar që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, duhet që të gëzojnë statusin e personit juridik të miratuar nga autoritetet përgjegjëse me ligj.
- 16.3 Llogaritë e shoqërisë auditohen çdo vit ushtrimor dhe në afate të tjera të ndërmjetme, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi, dhe në shoqëritë e kontrolluara, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të paraqesë te dyja grupet e pasqyrave financiare vjetore të kontrolluara, atë individuale dhe ato të konsoliduara. Raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara ja paraqet dhe dorëzon në kohë Asamblesë së Përgjithshme për ti shqyrtuar dhe miratuar.

## **Neni 17 – Depozitari<sup>4</sup>**

Shoqëria Komandite, që është fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar, nëshkruan një marrëveshje me depozitarin e licencuar të fondit të investimeve alternative, në zbatim të ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.


## **Neni 18 - Prishja dhe Likuidimi**

Shoqëria konsiderohet e prishur në rastet e parashikuara nga ligji i zbatueshëm. Në rast përrfundimi, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidues dhe tagrat përkatëse në përputhje edhe me kërkesat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), si dhe ligjit nr.56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

## **Neni 19 – Blerja, Bashkimi dhe Transferimi i Shoqërisë**

- 18.1 Shoqëria mund të blejë dhe të zotërojë kuota/aksione në një shoqëri tjetër, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), ligjit nr.56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

<sup>4</sup> “Depozitari i fondeve të investimeve alternative” - Ligji 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, neni 2, pika 16



18.2 Shoqëria mund të bashkohet apo transferohet sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), ligjit nr.56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## **Neni 20 – Baza Ligjore**

Shoqëria Komandite, që është fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar, do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut, dispozitat e ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive, si dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

## **Neni 21 – Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë Komandite dhe të tretëve, do të jetë Kompetente Gjykata Shqiptare, sipas organizimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Cdo ortak i shoqërisë është madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i vetëdijshëm mbi të drejtat dhe detyrimet të cilat përcaktohen në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, si dhe me vullnetin e tij të lirë njëj dhe nënshkruan Statutin e shoqërisë.

*Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.*

Lexuar, kuptuar, miratuar dhe nënshkruar nga Ortakët:


Për **Banka CREDINS sh.a.** zotërues në 97.91% të kapitalit themeltar:

**Z. MALTIN KORKUTI** (përfaqësues i autorizuar i Banka CREDINS sh.a.)

Për **Z. Arjan Hana** zotërues në 2.09% të kapitalit themeltar:

**Z. Arjan Hana**

*Arjan Hana*



Tiranë, më 21 / 02 / 2024